



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 26.09.2014

Për: Drejtorët e Përgjithshëm të Administratës, të Komunës së Lipjanit, Gjilanit, Skenderajit dhe Gjakovës

Lënda: Raporti me Rekomandime

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), përkatësisht Departamenti Ligjor dhe Monitorim i Komunave në bashkëpunim me Arkiven e MAPL-së kanë vizituar katër komunat e Republikës së Kosovës, Lipjanin, Gjilanin, Skenderajin dhe Gjakovën.

Qëllim i vizites ishte që të njihen nga afër me funksionimin e qendrave të shërbimeve me qytetarë në komuna në raport me arkivën/shkrimoren. Ministria është në fazën e plotësimit - ndryshimit të Udhëzimit administrativ 2011/03 (MAPL) për organizimin dhe funksionimin e qendrave të shërbimeve për qytetarë në komuna, konform Ligjit për administrimin e punës në zyrë Nr. 04/L-184. Vizitat u realizuan me Drejtorët e Administratës në komuna, Shefin e Qendrës së Shërbimeve të Qytetarëve dhe Arkivistin e komunës.

Nga këto vizita MAPL, ka hartuar raportin dhe ka nxjerr disa rekomandime për këto katër komuna.

Bashkangjitur gjeni raportin.

Me respekt,

Besnik Osmani,
Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së

Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim i Komunave,
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORT PËR KATËR KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË
2014

- Lipjani;
- Gjilani;
- Skenderaj dhe;
- Gjakova.

Komuna e Lipjanit

2

qendres se shërbimeve të qytetarëve pastaj në arkiv. Komuna kishte librin intern dhe librin e protokollit (vetem në mënyrë elektronike). Librin e protokollit në mënyrë fizike nuk e përdorin prej kur ka filluar të aplikohet sistemi i intranetit. Të gjitha lëndët që regjistrohen nxirren (shtypen në kopje fizike) në fund të muajit. Të gjitha shërbimet për qytetarë shkonin përmes qendres së shërbimeve të qytetarëve sipas Udhëzimit administrative Nr.2011/03, përveç regjistrimit të biznesit që kishte zyrën e vetë dhe i raporton Drejtorise së ekonomisë dhe financave. Problemi kryesor në këtë komunë ishte sistemi, për shkak të afatit të lëndëve të ndryshme, për arsye se te disa lëndë afati është me i shkurtër e te disa me i gjatë, dhe sistemi nuk ju lejon ti përdorin afate tjera përveç afatit 30 ditë, ku komuna kërkoi që të shtyn afatin deri në 45 dite, për shkak se performanca e tyre po del shumë e dobët në krahasim me lëndët që ju kan përgjigje. Është konstatuar se Komuna e Lipjanit e zbaton pjesërisht Udhëzimin Administrativ Nr.2011/03.



Foto 1: (Komuna e Lipjanit)

Komuna e Gjilanit

Me datën 21 gusht në orën 13:00 është vizituar Komuna e Gjilanit, nga ekipi i MAPL-së. Në takim u pritëm nga z.Nazim Gagica, Drejtori i administratës së përgjithshme, dhe z.Kujtim Bajrami, Shefi i qendrës së shërbimeve të qytetarëve. Qendra për Shërbim të Qytetarëve kishte tetë (8) zyrtarë për pranim të kërkesave/parashtresave si dhe dokumente tjera. Komuna kishte librin intern dhe librin e protokollit (vetem në mënyrë elektronike). Librin e protokollit në mënyrë fizike nuk e përdorin prej kur ka filluar të aplikohet sistemi i intranetit. Të gjitha lëndët që regjistrohen nxirren (shtypen në kopje fizike) në fund të muajit. Të gjitha shërbimet për qytetarë nuk shkonin përmes qendres së shërbimeve të qytetarëve sipas Udhëzimit

administrative Nr.2011/03, regjistrimi i biznesit, tatimi në pronë, si dhe shërbimi i gjendjes civile nuk shkon përmes qendres së shërbimeve të qytetarëve, ku sipas zyrtarëve të komunës problemi ishte intraneti si dhe ministrit përkatëse (MPB, MTI dhe MF) që kanë programet e tyre për këto shërbime dhe nuk iu është lejuar që ato shërbime të shkojnë përmes qendrës së shërbimeve të qytetarëve. Është Konstatuar se Komuna e Gjilanit e zbaton pjesërisht Udhëzimin Administrativ Nr.2011/03.



Foto 2: (Komuna e Gjilanit)

Komuna e Skenderajt

Me datën 22 gusht në orën 10:30 është vizituar Komuna e Skenderajt, nga ekipi i MAPL-së. Në takim u pritëm nga znj. Alberta Gjinovci, Drejtore e administratës së përgjithshme, z. Hamit Geci, Shefi i qendrës së shërbimeve të qytetarëve. Qendra për Shërbim të Qytetarëve kishte tre (3) zyrtarë për pranim të kërkesave/parashtresave si dhe dokumente tjera. Komuna kishte librin e protokollit (vetëm në mënyrë elektronike). Librin e protokollit në mënyrë fizike nuk e përdorin prej janarit të këtij viti. Të gjitha lëndët që regjistrohen nxirren (shtypen në kopje fizike) çdo ditë. Të gjitha shërbimet për qytetarë shkonin përmes qendres së shërbimeve të qytetarëve konform Udhëzimit administrative Nr.2011/03. Zyrtarët të komunës e zbatonin në përpikri Udhëzimin Administrativ Nr.2011/03. Po ashtu edhe në këtë komunë kishte problem me sistemin/intranetin. Propozimi i zyrtarëve të kësaj komune ishte që Qendra për Shërbime të

Qytetarëve sipas Udhëzimit Administrativ të kaloj në “Njësien për Administrimin e Dokumentave” sipas Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në zyre. Është konstatuar se në Komunën e Skenderajt Udhëzimi Administrativ Nr.2011/03 zbatohet plotësisht.



Foto 3: (Takim me Drejtoreshen e Administratës së Përgjithshme, Komuna e Skenderajt)



Foto 4: (Qendra për Shërbime të Qytetareve, Komuna e Skenderajt)

Komuna e Gjakovës

Me datën 22 gusht në orën 14:00 është vizituar Komuna e Gjakovës, nga ekipi i MAPL-së. Në takim u pritëm nga z.Armend Vokshi, Drejtori i administratës së përgjithshme dhe z. Nexhat Shujaku, Arkivist në komunë. Komuna e Gjakovës ofron shërbimet për qytetare në një format tjetër jo konform Udhëzimit Administrativ Nr.2011/03. Arkiva kishte tre (3) zyrtarë për pranim të kërkesave/parashtrësive si dhe dokumente tjera. Komuna kishte gjashtë (6) libra intern për secilin drejtor veq e veq, po ashtu kishte librin e protokollit (vetëm në mënyrë elektronike). Librin e protokollit në mënyrë fizike nuk e përdorin. Të gjitha lëndët që regjistrohen nxirren (shtypen në kopje fizike) në fund të çdo muaji. Komuna kishte themeluar Qendrë informative, që dy muaj të kontraktuar për gjashtë (6) muaj financim me mbështetjen e KDI-së në të cilën punonin katër (4) zyrtarë. Roli i kësaj qendre ishte informimi i qytetarëve dhe adresimi i tyre në zyrën e pranimi dhe drejtoritë brenda komunës. Po ashtu edhe në këtë komunë kishte problem me sistemin/intranetin. Shërbimet ishin të shpërndara jo të gjitha shkonin përmes Qendrës për Shërbim të Qytetarëve. Sipas drejtorit të administratës së përgjithshme shërbimet e qytetarëve kalohen nga Qendra informative përmes zyrës së pranimi. Është konstatuar se kjo komunë nuk e zbaton në tërësi Udhëzimin Administrativ Nr.2011/03.




Foto 5: (Takim me Drejtorin e Administratës së Përgjithshme, Komuna e Gjakovës)



Foto 6: *(Ofrimi i Shërbimeve për Qytetarët, Komuna e Gjakovës)*



Foto 7: *(Arkiva dhe zyra pritese, Komuna e Gjakovës)*

Rekomandimet nga MAPL-së për katër komunat (Lipjan, Gjiilan, Skenderaj dhe Gjakovë)

- Të ndërhyhet në sistemin elektronik (intraneti) nga zyrtarët e IT-se, p.sh çështja e pagesave ka probleme sistemi në katër komunat e vizituara;
- Qendrat e Shërbimeve të Qytetarëve në këto komuna të nxjerrin në baza ditore protokollin elektronik;
- Protokolli elektronik në keto komuna të ruhet në arkiv të komunës;
- Komunat e vizituara Lipjani, Gjilani, Gjakova të mbajnë një libër të protokollit ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi (ngase ka komuna që i mbajnë 7, 8 libra brenda komunës varësisht sa drejtori kanë);
- Të gjitha shërbimet të cilat kryhen në komunën e Lipjanit, Gjilanit dhe Gjakovës të shkojnë përmes Qendresë së Shërbimeve të Qytetarëve sipas Udhëzimit Administrativ nr.2011/03, duke përjashtuar Skenderajn;
- Komunikimi i shkresave në këto komuna të bëhet përmes, Qendrave për Shërbime të Qytetarëve në drejtori brenda komunës të bëhet në formë elektronike jo përmes librave intern siç parashihet me Udhëzimin Administrativ Nr.2011/03;
- Ofrimi i shërbimeve në këto komuna, përmes sistemit elektronik të bëhet në mënyre unike për të gjitha shërbimet (tatimi në pronë, regjistrimi i bizneseve, gjendja civile etj, ashtu siç parashihet me Udhëzim Administrativ nr.2011/03);
- Komuna e Lipjanit nuk posedonte vulën dalese të komunës prej 6 muajsh dokumentet dalin pa vule dalëse;
- Komuna e Lipjanit, Gjilanit dhe Gjakova, akoma nuk e kanë të qartë dallimin në mes të zyrtarit të shkrimores dhe arkivistit;
- Kemi konstatuar se në Komunën e Lipjanit, Gjilanit dhe Gjakovës, Qendrat për Shërbime të Qytetarëve nuk funksionojnë ashtu siç është e parapare me Udhëzimin Administrativ Nr.2011/03;
- Të gjitha shërbimet nuk ofrohen përmes Qendrës për Shërbime të Qytetarëve, në komunën e Lipjanit, Gjilanit dhe Gjakovës, psh regjistrimi i bizneseve, tatimi në prone, gjendja civile, janë ndaras nuk kryhen ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ nr.2011/03/, që të gjitha këto shërbime duhet të ofrohen përmes Qendrës për Shërbime të Qytetarëve;

Raporti është hartuar nga:

Edona Berisha, Zyrtare e lartë për zhvillim dhe harmonizim të legjislacionit në MAPL
Bashkim Bardoniqi, Arkivist në MAPL

Në mbikëqyrje te:

Flutura Hoxha, Udhëheqese e Divizionit për Zhvillim dhe Harmonizim të Legjislacionit
në MAPL